

Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve

Palët e interesuara, komentet dhe rekomandimet e tyre mund ti dërgojnë në bashkiabelsh@hotmail.com ose me postë në adresën Bashkia Belsh, Rruga Haziz Dervishi, Belsh, ose në fatmira.broshka@bashkiabelsh.gov.al (Koordinatorë e njoftimit dhe konsultimit publik).

Komentet dhe rekomandimet, grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik, në mënyrë të strukturuar dhe transparente. Shqyrtimi i tyre, kryhet nga bashkia, e cila vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve. Nëse rekomandimet nuk janë pranuar, bashkia paraqet një përmbledhje të arsyeve të mospranimit.

Adresa postare/elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve

bashkiabelsh@hotmail.com

fatmira.broshka@bashkiabelsh.gov.al

Bashkia Belsh, Rruga Haziz Dervishi, Belsh

Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve

Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimmarrës komentet dhe rekomandimet e tyre: a) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak; b) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, sipas vendimit të organit publik, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit.

Zgjatja dhe përsëritja e fazës së konsultimit:

Organi publik mund të zgjasë afatin për dërgimin e komenteve ose mund të ripërsëritë fazën e marrjes së komenteve e të rekomandimeve në rastet kur:

a) organi publik nuk është i kënaqur me cilësinë e komenteve të përfutuara;

b) në komentet dhe rekomandimet e dhëna janë ngritur çështje të reja të rëndësishme që nuk kanë qenë pjesë e konsultimit fillestar